



Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)



Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

# REPUBLIKA E SHQIPERISE

## RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

(Ligji nr.10.440, shtojca II, Pika 10/b)

PER KONTRATEN

*“NDËRTIM SHKOLLA E MESME E BASHKUAR MERSIN DUQI”*

*NJESIA ADMINISTRATIVE BËRZHITË, FSHATI IBË, TIRANE*



**POROSITES**

**BASHKIA TIRANE**



**KONSULENT**

**JV TOWER sh.p.k. & Taulant sh.p.k**



Tirane 2023



Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

## **PERMBAJTJA E RAPORTIT TE VNM-SE SE PARAPRAKE**

1. Hyrje;
2. Tipologjia e raportit;
3. Pershkim i legjislacionit ne fuqi;
4. Baza legjislative;
5. Te dhena per shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit,dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- 5.1 Vendodhja e objektit
- 5.2 Pershkrimi i objektit dhe struktures
- 5.3 Foto te gjendjes ekzistuese
- 5.4 Projekti arkitektonik
6. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet te zbatohet projekti;
7. Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e projektit dhe në afërsi të tij;
8. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet ne biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
9. Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
10. Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
11. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
12. Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;



## 1. HYRJE

Projekti i propozuar synon Përgatitjen E Projektit Per Ndertimin e **Shkollës së Mesme së Bashkuar “Mersin Duqi”**, **Bashkia Tirane**, Bazuar ne ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011, “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” shtojca II, klasifikohet si aktivitet qe i nenshtrohet procedures Paraprake te Ndikimit ne Mjedis dhe pajiset me Vendim per VNM Paraprake. Specifikisht klasifikohet ne piken 10. Prodhime infrastrukturore pika b) Projekte per zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndertimin e qendrave tregtare dhe parkimet per makina.

Qellimi kryesor i ketij projekti bashkekohor eshte qe te plotesoj te gjitha kushtet per te cilen do te ndertohet. Qellimi i hartimit te ketij raporti teknik eshte mbi vleresimin e pergjithshem, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve qe do te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis me qellim mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendryshem te tij.

## 2. TIPOLOGJIA E RAPORTIT

Ky raport u mbështet ne pika 10/b “Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat”, e Shtojcës II, Nr.10 440, datë 7.7.2011 (I ndryshuar me ligjin 12/2015), për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, do të marrë parasysh sugjerimet dhe bashkëpunimin me ekspertët dhe specialistet rajonale e vendore, në bazë të eksperiencave dhe përvojave të tyre, materialet ekzistuese, gjetjet e studimeve paralele, konsultime të vazhdueshmeme palët e interesuara, që mundësuan një përpunim të materialit të fokusuar në vlerësimin endikimeve, planin e menaxhimit dhe programin e monitorimit.

## 3. PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT NË FUQI

Gjatë dhjetë-vjecarit të fundit qeveria ka filluar zhvillimin e një kuadri ligjor dhe ka ndërmarre nisma te ndryshme për të ndryshuar degradimin mjedisor me synimin kryesor:

**“Të mirëmbajë një mjedis të përshtatshëm të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”.**

Për më tepër, Legjislacioni kërkon që burimet natyrore duhet të shfrytëzohen racionalisht në përputhje me principe të bazuara. Politikat e përpiluara për mjedisin janë pasqyruar ne ligjin e vitit 2011.

Kreu IV “Mbrojtja e Mjedisit ne procesin e planifikimit” përcakton politiken e qeverisë për:

**Politika shtetërore mjedisore** – përcakton pozicionin e mjedisit në legjislacion, vendin e strategjive të sektoreve kombetare dhe planet lokale si pjesë e politikës mjedisore dhe përcakton organizmat të cilët do të administrojnë këto politika.

**Strategjite dhe planet mjedisore** – përcakton Ministrine si organin përgjegjes për hartimin periodik të strategjive dhe planeve mjedisore për secilin nga përbërësit e mjedisit.

**Planet vendore te veprimt per mjedisin** – kërkojnë nga qeverisja lokale të përgatitin plane veprimvendore për mjedisin në mënyrë periodike në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji. Kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshilline qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.

**Planet e zhvillimit** - përfshijnë instrumentet e parashikuara në planifikimin kombëtar, vendor e ndërvendor, dhe planifikimin e integruar dhe kërkojnë nga autoriteti publik përkatës të mbajë parasysh veçanërisht ndjeshmërinë e mjedisit të një zone të caktuar gjatë hartimit dhe miratimit të planeve të zhvillimit.



#### 4. BAZA LEGJISLATIVE

Seksioni i mëposhtem i këtij raporti paraqet në mënyrë përmbledhese ligjet dhe normat përkatëse që janë marre në konsideratë.

Miratur në vitin 1998, Kushtetuta e Shqipërisë përcakton kornizën e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe miraton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe të drejtën e publikut për lirinë e informacionit mbi mjedisin.

Kuadri ligjor vendor Legjislacioni mjedisor është ndertuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit. Keshtu, ndër me specifiket mund të përmendim:

Keshtu, ndër me specifiket mund të përmendim:

Ligjin Nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit"

Ligji Nr.10 440, date 7.7. 2011, "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis".

Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"

Ligji Nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" Vendim Nr. 177, date 6.3.2012 "Per ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

Ligji Nr. 10119 date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit" ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" Ligji Nr.9587, date 20.07.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit" Ligji Nr.10 081, date 23.02.2009 "Per Licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".

VKM Nr. 686, date 29.07.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore".

Vendim i KM Nr.1189, Date 18.11.2009 "Per Rregullat Dhe Procedurat Per Hartimin Dhe Zbatimin e Programit Kombetar Te Monitorimit Te Mjedisit"

Vendimi i KM Nr. 805, dt 04.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis,per te cilat kerkohet Leje Mjedisore".VKM-së nr. 435 datë 12.09.2015 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

Vendimi i KM Nr.247, date 30.04.2014 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin".

Vendim i KM Nr. 123, date 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"

Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"

Vendim i KM Nr. 99, date 18.2.2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve

Vendim i KM Nr. 177, date 31.3.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisve ujore pritese"

Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"

Vendim i KM Nr. 16, date 14.01.2012 "Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor"

Vendim Nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror"

VKM Nr. 575, date 24.06.2015, "Per menaxhimin e mbetjeve inerte" Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne republiken e shqiperise. Ne parlamentin Shqiptar jane miratur edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme.

Nder to përmendim:

Ligji Nr. 9672 date 26.10.2000: "Per ratifikimin e konventes se Aarhusit" Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimmarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjete mjedisit.

Ligji Nr. 9334 date 16.12.2004: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos" ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).

Ligji Nr. 9424 date 06.10.2005: "Per ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor". Ligji Nr. 9486 date 06.03.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit" Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.

Ligji Nr. 9548 date 01.06.2006: "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve"

Hartimi i kesaj VNM -je dhe zbatimi i ketij projekti është i mbikqyruar nga disa institucionet qëndrore dhe ato lokale për zbatimin me rigoroz të të gjitha ligjeve dhe normave të parashtruara në ligjet përkatëse sipas institucioneve dhe kopentecave te tyre.



Hartimi i këtij raporti VNM është bërë në përputhje me ligjin nr. 10 440, datë 07.07.2011,"për vlerësimin e ndikimit në mjedis ", ku sipas shtojcave të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, dhe projekti në fjalë i nënshtrohet procedurës parapraketë vlerësimit të ndikimit në mjedis Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukurore  
b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat.

## 5. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN DHE VENDNDODHJEN E PROJEKTIT

**Projekti: "NDËRTIM SHKOLLA E MESME E BASHKUAR MERSIN DUQI" NJESIA ADMINISTRATIVE BËRZHITË, FSHATI IBË, TIRANE**

### 5.1 VENDNDODHJA E OBJEKTIT

Shkollës së Mesme së Bashkuar "Mersin Duqi" do të ndërtohet në Njësinë Administrative Bërzhitë, Bashkia Tiranë. Sheshi ekzistues ka një sipërfaqe totale prej 2215 m<sup>2</sup>. Kjo parcele do shfrytëzohet për ngritjen e objektit prej 3 katesh me njollë ndërtimi prej 1057m<sup>2</sup>.

#### Planvendosje ekzistuese



#### Koordinatat karteziante:

X=4573534      Y=4405390

Lartësia mbi nivelin e detit: Z=207,40m

#### Koordinatat sipas KRGJSH:

E=19.935740 ml

N=41.239667 ml



Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

## 5.2 PROJEKTI ARKITEKTONIK

### Te dhena mbi siperfaqet:

Sip. totale e prones: 2215m<sup>2</sup>

Sip. e njolles : 1057m<sup>2</sup>

Sip. e ndertuar: 2009m<sup>2</sup>

Nr. i femijeve : 185

Nr. I klasave : 13

Lartesia e katit : +3.50 m

Lartesia e objektit: +11.85m

Intensiteti i Ndertimit 0.73

Koeficienti i Shfrytezimit 47 %

### Planimetririte

### Ambjentet e Propozuara:

Ambjentet e propozuara janë në përputhje me detyrën e projektimit dhe më konkretisht:

#### Kati perdhe :


1. Ambjente të përbashkëta:  
-Hapsira për korridore duke përfshirë dhe shkallët
2. Ambjentet e Shkolles:  
-2 klasa  
  
-1 klase per parashkollorin  
  
-2 laboratore informatike  
  
-1 laborator fizike  
  
-1 laborator biokimi  
  
-Zyra e drejtorit  
  
-Ambjent për asistence mjekësore  
  
-Tualete  
  
-Zyre psikologu





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
 Cel. +355(0)694058048  
 e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
 Tel +355 4 2456016,  
 e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)











Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjok Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

**Fasada jugore**



**Fasada lindore**






Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

## Fasada perendimore



## Rendera





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)





### 5.3 FURNIZIMI ME ENERGJI ELETRIKE

Si burim furnizimi per objektin do te sherbeje Kabina e OSHEE me e afert me objektin qe mbetet per tu vendosur ne faze zbatimi mbas nje konsulte me specialistet e OSHEE.

Furnizimi i kopshtit parashikohet te behet me linje te dedikuara me modalitet kalimi ne tub korrugato dopio shtrese nentoke. Pajisjet elektronike si centarli i detektimit te zjarrit, centrali i antivjedhies, njesite Rack, linjat e furnizimit te posteve te punes ose postet e kompjuterave ne sallat e informatikes do te kene Back-Up UPS per te mos u ndikuar nga kycje-ckycjet e rrjetit. Ups-i do te jete i vendosur ne katin e pare dhe do te jete i vetem per te gjitha objektin. Ne kete menyre ulen kostot e mirembajties dhe operimit te njesise UPS.

Instalimet elektrike jane me mbrojtje nga prekja direkte dhe indirekte, nga mbingarkesat dhe rrymat e lidhjeve te shkurtera. Percjellesat dhe kabllot pergjithesisht jane te tipit joperhapes zjarri dhe me clirim te reduktuar gazesh korozive sipas standartit referuar kablllove qe perdoren ne ambiente shkollash.

### 5.4 MBROJTJA NDAJ ZJARRIT

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri do te jete terresisht i ri.

*Do te kemi:*

Impiante te palevizshme te shuarjes e zjarrit

Pajisjet e levizshme te shuarjes se zjarrit

Bombola portative dhe karelato (shkume, pluhur, gaz) (aplikohen ne pergjithesi ne te gjitha godinen)

*Hidrantet e zjarrit me uje ne ketë objekt nuk janë aplikuar sepse objekti është me një lartësi  $h < 12$  m kështu që mund të aplikohen vetëm fikset portative.*

Fikset me pluhur janë pajisje që përdoren në rast zjarri, të cilët zakonisht janë të adoptuar për të gjitha tipet e zjarrit-kjo shpjegon edhe arsyen se përse keto pajisje i gjejmë pothuajse në çdo ambient

Shuares zjarri portabel, me pluhur si edhe shuares zjarri me anidrid karbonik (per ambjentet teknike) do te vendosen ne pozicionet e percaktuara ne projekt. Numri i shuaerve portabel dhe pozicioni i tyre ne godine jane percaktuar ne menyre te tille qe te mund te garantohet lehtësia e arritjes tek hidranti.

### 5.5 UJESJELLES DHE KANALIZIMI

Sasia e ujit per konsum per nxenes dhe personeli i kopshtit percaktohet ne baze te sasise te ujit nxenes /dite dhe rendesise se objektit qe furnizohet.

Volumi i rezerves se ujit per kopshtin eshte marre  $2.7 \text{ m}^3$  me afërsi për 185 fëmijë. Duke u nisur nga tabela e mesiperme kemi keto llogaritje  $185 \text{ fëmijë} \times 15 \text{ litra} / \text{per fëmijë} = 2700 \text{ litra}$  atëhere vëllimi i domosdoshëm ditor është 2700 litra, ne kemi pranuar një rezervuar 3500 litra .Ky rezervuar uji është kalkuluar dhe dimensionuar qe te sigurojne nje presion dhe sasi uji ne qender per nje autonomi te kerkuar prej 48 oresh.

### 5.6 KERKESA MBI KRITERET KONSTRUKTIVE DHE FUNKSIONALE

#### Themelet

Objekti ne fjale eshte nje objekt arsimor, me funksion kopshtin per femijet. Ndertesa propozohet te jete 3 kate. Ne baze te gjitha te dhenave te mesiperme kemi konsideruar per stuktoren tone shtresen mbrojttese: per soletat 20 cm, per traret 30 cm per kollonat 30 cm x 60 cm dhe per. Themeli i strukturës është realizuar i tipit pllakë b/a.

#### Tarraca

Tarraca e shkollës do te termoizolohet dhe hidroizolohet sipas detajeve te dhena ne projekt.

#### Dyshemeja

Soletat jane parashikuar b/a solete monolite me lartesi 20 cm. Betoni qe do te perdoret duhet te jete i klases C25/30 dhe hekuri B500C



## Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Objektet do të kenë sistemin e mbrojtjes atmosferike. Sistemi i mbrojtjes atmosferike është bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

## 6. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.

### Biodiversiteti

Territoret e bashkisë së Tiranës vazhdojnë të ruajnë shumëllojshmëri dhe sasi të konsiderueshme të biodiversitetit. Këto territore bëjnë pjesë në zonën biogeografike mesdhetare dhe shquhen për diversitet të lartë të ekosistemeve detare, bregdetare, lagunore, kënetore, lumore, të shkurretave mesdhetare përherë të gjelbërta dhe gjetherënëse dhe dushqeve.

Megjithatë, grupe të shumta bimore dhe shtazore janë ende të panjohura e të pastudiuara. Mungesa e njohurive shkencore rreth potencialit dhe vlerave të botës bimore dhe shtazore ka bërë që në vazhdimësi kjo pasuri të mos vlerësohet ekonomikisht, çka do të sillte rritje të të ardhura tek banorët vendas.

Sipas Konventës së Biodiversitetit (1994): “Pasuritë gjenetike, organizmat, popullimet apo çdo komponent tjetër biotik me potenciale aktuale të vlerës dhe përdorim të njeriut konsiderohen resurse biologjike”. Territoret e të dyja bashkive kanë bimësi të katit të shkurreve mesdhetare ( përherë të gjelbërta e gjetherënëse), bimësi të katit të dushqeve dhe përfaqësues të katit të ahut pavarësisht lartësisë së vogël mbi nivelin e detit.

Në këto territore gjendet edhe një pasuri e madhe shtazore, si tokësore dhe ujore.

### Pasuria bimore (Flora)

Burimet pyjore janë të gjithë elementet natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlerë të konsiderueshme, të përdorshme për nevojat e njeriut.

Territoret e bashkisë së Tiranës bëjnë pjesë në katin fito-klimatik të shkurreve mesdhetare (makje-shibjaku) dhe të dushqeve. Fizionomia e bimësisë së kësaj zonë karakterizohet kryesisht nga shkurre gjithmonë të blerta dhe pjesërisht nga shkurre që i lëshojnë gjethet gjatë stinës së dimrit.

Nga shkurret me gjethë gjithmonë të blerta, që bëjnë pjesë në ndërtimin e makjes, më karakteristike janë: mareja ( *Arbutus unedo* L.) mërsina ( *Myrtus communis* L), xina ( *Pistacia lentiscus* L), shqopa ( *Erica arborea* L.), gjëneshtira ( *Spartium junceum* L.), dafina e egër ( *Laurus nobilis*) etj. Nënkatit i shibjakut përfaqësohet nga bungëbuta ( *Quercus pubescens*), shkoza e zezë ( *Carpinus orientalis*) dhe frashëri i bardhë ( *Fraxinus ornus* L.) Në këto territore gjenden formacione të vogla natyrore të pyjeve të lagura ( higrofile). Ato janë të përhapura në grykëderdhjen e lumenjve Erzen dhe Ishëm, në tokat aluvionale dhe në tokat bregdetare me nivel të lartë të ujërave nëtokësore. Përgjatë rrjedhjes së poshtme të Erzenit dhe Ishmit gjenden formacione me Vidha ( *Alnus glutinosa*), Rrape ( *Platanus orientalis*), Shelg të bardhë ( *Salix alba*), Shelg të kuq ( *Salix purpurea*) dhe Plepa të bardhë ( *Populus alba*). Në zonën e Rrushkull-Hamallajt gjendet një brez i ngushtë i pyjeve halorë mesdhetare me specie dominante: Pishë bregdetare ( *Pinus pinaster*), Pishë e egër ( *Pinus halepensis*) dhe rrallëherë Pishë e butë ( *Pinus pinea*), e kultivuar 40 – 50 vjet më parë për stabilizimin e dunave ranore dhe mbrojtjen e tokave bujqësore. Si shoqërues i katit shkurror dhe pyjor është mbulesa bimore, kryesisht e tipit umbrofil. Shoqërimet kryesore bimore të zonës janë: Fieri ( *Petris aquiliana*), Lisna ose Timusi ( *Thymus vulgaris*), Shelgu i Bardhë ( *Salix alba* L.), Telishi ( *Dactylis glomerata*), Vicia ( *Vicia Dasycarpa*), Menishtet ( *Cistus salvifolius*), Festuca ( *Festuca varia*), Teukli ( *Teocrium polium*), Bocka ( *Urginea maritima* bok), Tërfile ( *Trifolium pratense*), Shpendra ( *helleborus edours*), Lule shqerra ( *Bellis perennis*), Geranium ( *Geranium pyrenacium*), Barbstari ( *Sanguisorba officina*), Ban i bletës ( *Meishema officinalis*), Hedera ( *Hedera helix*), Qumështorja ( *Euphorbia cuparisias*), Hithra ( *Urtica dioica*) Mellaga ( *Althaea officinalis*) etj. Në këto territore rritet bimë mjekësore dhe





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë

Cel. +355(0)694058048

e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,

Tel +355 4 2456016,

e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

aromatike si: Mimoza ( Acacia dealbata), Petriku kulper ( Aristolochia clematitis), Pelini i Zi ( Artemisia vulgaris), Minuri si pelin deti ( Chenopodium ambrisiodos), Menishtja me push ( Cistus incanus), Ekualipti rruazor ( Eucaliptus globulus), Dëllinja e kuqe ( Juniperus oxycedrus), Fidhësi ( Juniperus communis), Dafina ( Laurus nobilis), Mëllaga ( Malva silvestris), Rigoni i Bardhë ( Origanum vulgare), Lulëkuqja ( Papaver rhoeas), Majdanoz ( Petroselinum sativum), Pisha e butë ( Pinus pinea), Trumza ( Saturea montana), Bar majasëlli ( Teucrium polium), Matriku ( Vinca major) dhe Konopica ( Vitex agnus-castus).

### **Zona me rendesi te vecante**

Territori ne studim nuk eshte e perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur apo zone buferike, te cilat ruhen ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi. Zona ne studim nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura me interes nderkombetar apo te cenoj ndonje nga konventat e nenshkruar.

## **7. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE, NË SIPËRFAQEN E PROJEKTIT DHE NË AFËRSI TË TIJ.**

### **Ujëmbledhësit artificialë**

Lumi i Erzenit është i gjatë 108 km, me prurje rreth 102 l/sek. Uji i këtij lumi që rrjedh në një terren shkëmbor gjatë shekujve ka krijuar kanione spektakolare. Uji i kristaltë dhe thellësia e kanioneve të krijuar mundësi të lahesh apo të notosh. Në pjesën ku lumi ka një thyerje rreth 10 m është krijuar një ujëvarë brenda një guve. Përpara ujëvarës tek kanionet ka vaska të cilat në stinën e nxehtë përdoren për tu larë.

Ky është nga kanionet më të bukura të zonës së Tiranës. Ka një gjatësi prej 1.08 km dhe shtrihet në grykën e Skoranës. Kanioni është i mbushur me vaska , katarakte, guva e ngushtica nga të gjitha format. Natyra ka krijuar në miliona vjet një pamje spektakolare. Për të arritur deri atje shkohet nga Tirana deri në fshatin Pellumbas me rrugë automobilistike dhe të mirë. Më pas procedohet në këmbë deri tek kanioni.

Diku në mesin e tij janë tre burime që burojnë shumë pranë tij dhe një prej tyre në brendësi të shtratit. Dy prej burimeve kane ujë me mineral squfuri. Kjo bën që uji nga burimet e poshtë të ketë një ngjyrë të kaltër në blu, ndërsa mbi burime ai është me ngjyrë të gjelbër. Uji i kristaltë dhe thellësia e kanioneve krijojnë mundësinë për të notuar në të. Në anën e brendshme të një zgavrave, lumi është i thellë deri në 10 metra. Ka gropa në vendin ku derdhen ujëvarat, të cilat gjatë verës përdoren për të notuar dhe bërë plazh. Sot është një vend i frekuentuar shpesh nga dashamirësit e natyrës.

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, duke parë potencialin e madh që ofron ky territor, ka filluar ta shfrytëzojë si zonë rekreative për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme outdoor, duke u përqendruar mbi të gjitha tek sportet ujore, për ta kthyer atë në një pikë referimi për frekuentuesit e të gjitha grupmohave të cilët duan të kalojnë disa orë të qeta në ajër të pastër e larg zhurmës së qytetit.



## Klima

Zona e studiuar ben pjese ne zonen me klime mesdhetare fushore, me sakte ne nenzonen klimatike mesdhetare fushoro-qendrore te Shqiperise. Sasia e rreshjeve vjetore luhetet nga 950 m/m-1100 m/m. Numri i diteve me rreshje eshte 85-100 dite ne vit.

*Te dhenat per rreshjet jane marre nga buletinet e IGJEUM-it*

*Tabela Nr.1 –Mesataret mujore te rreshjeve ne m/m*

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
107	99	87	74	76	41	24	30	67	105	131	117	958

Sasia minimale eshte ne Korrik-24 m/m dhe maksimale ne Nentor -131 m/m

Rreshjet e debores mungojne ne zone.

Temperaturat e ajrit, mesatarisht per te gjithë vitin arrijne ne 15-16 grade C.

Temperaturat me te ulta jane ne Janar-5-6 grade C .

Temperatura maksimale arrin deri ne 39.5 grade C

*Drejtimi i Eres dhe shpejtesia e saj.*

Drejtimet e eres jane te ndryshme .Shpejtesite e tyre varijojne nga 2.2 m/sek ne 5.4 m/sek

Drejtimi i Eres	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW
Shpejtesia e Eres-m/sek	3.4	2.7	2.2	2.3	3.9	5.4	4.1	4.1

## Gjeologjia dhe dherat

*Te Dhena mbi Ndertimin Gjeologjik te Zones se Studimit*

Zona e studimit ndodhet ne qytetin e Tiranës dhe ndertohet kryesisht nga depozitime te Kuaternarit, depozitimet e Pliocenitpo dhe te Miocenit te Siperem.

*Depozitimet e Miocenit te Siperem (N1-3)*

Depozitimet me te vjetra ne zonen e studjuar jane ato te Miocenit te Siperem me konkretisht te Mesinianit keto depozitime perfaqesohen nga litofacie argjilo-ranore, qe perbehen nga nderthurje te paketave ranorike me paketa argjilo-alevrolitore. Ranoret mbizotrojne ne prerje dhe paraqiten ne trajten e paketave me trashesi 6-7m deri ne 15-20m ne keto depozitime perfshihen dhe litofacie gipsmbajtese, qe perfaqesohen nga argjila dhe alevrolite, te nderthurura me gipse shtrese trashe. Trashesia e depozitimeve te mesinianit arrin ne 600-800m.

*Depozitimet e Pliocenit*

Keto depozitime perfaqesohen nga Formacioni „Helmesi“ dhe Formacioni „Rrogozhina“. Formacioni „Helmesi“ fillon me shfaqjen ne prerje te shtresave ranore dhe te konglomerateve te pangopur, qe shenojne pranine e transgresionit pliocenik. Mbi shtresat ranore dhe konglomeratike vijojne shtresa argjilore, paketa argjilo-ranore dhe argjila masive. Ne Tirane trashesia e tyre arrin ne 700 m. Ky formacion perben Pliocenin e Poshtem (N2-h)



Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë  
Cel. +355(0)694058048  
e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,  
Tel +355 4 2456016,  
e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

### *Plioceni i Mesem*

Ne prerjet e plota, ne Pliocenin e mesem perfshihet, pjesa me e sipërme e formacionit, Helmesi dhe teresisht formacioni Rogozhina.

Pjesa e sipërme e formacionit „Helmesi“eshte vazhdimesi normale e pjeses se poshtme. Ne prerje ndeshen argjila shtresore here-here me pamje masive. Depozitimet e formacionit „Rrogzhina „ vendosen mbi pakon argjilore te formacionit „Helmesi“, duke patur marredhenie normale me te. Keto depozitime kane karakter trashaman. Dhe perfaqesohen nga ranore, gravelite, konglomerate me zaje qe nderthuren me paketa ranorësh,me trashesia 4-6m.Ranoret jane poliminerale, te tipit kuarcoro-feldshpatik me permbajtje serpentinas. Trashesia e ketij formacioni arrin deri ne 1400m.

### *Depozitimet e Kuaternarit*

Depozitimet e Kuaternarit mbizoterojne ne zonen e studimit. Ato perfaqesohen nga depozitime aluviale, depozitime aluviale-proluviale, depozitime lagunoro-kenetore. Ne territorin e zones se studjuar ka patur nje veprimtari intensive si per transportin e sedimenteve ashtu dhe per akumulimin e tyre. Ne kete rajon formacionet e aluvioneve te shtruara ne shtreterit e vjeter te lumit Erzen, i takojne Holocenit te vonshem. Depozitimet aluviale perfaqesohen nga rera te imta, alevrite dhe argjila. Trashesia e tyre eshte 20-30m.Depozitimet lagunoro-kenetore perfaqesohen nga nderthurje te shtresave argjilore, alevritore dhe rera trashesia e tyre arrin deri ne 10-15 m.

## **Sizmiciteti**

Në zonimin sizmik mbarëbotëror, Shqipëria zë vënd në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili eshte nderme aktivet ne bote. Rajonet që rrethojnë Shqipërinë përfshijnë një zonë tektonike mjaft të gjërë, të përbërë nga blloqe relativisht të shtangët si Adriatiku, disa sektorë të brezit Alpin, Alpeve, Karpateve, Vargmaleve Ballkanikë, Dinarideve, Helenideve, Harkut Helenik, brezit të Anadollit sidhe basenet e brëndëshme të Tirrenit, Egjeut, Panonian dhe Detit të Zi.

Në brezat e mësipërm, pjesa më aktive nga pikpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon (34-43° N; 18-30° E), ndodh të paktën një tërmet me  $M > 6.5$  (Papazachos, 1989).

Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ( $1.0 < M \leq 3.0$ ), nga shumë tërmete të vegjël ( $3.0 < M \leq 5.0$ ), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ( $5.0 < M \leq 7$ ) dhe shumë rrallë tërmete të fortë ( $M > 7.0$ ).

Pergjithesisht termetet e Shqiperise dhe rajoneve per rreth kane vatra te cekta, thellesia e te cilave shkon nga 10 -25 km. Zakonisht, sizmiciteti i një vëndi ndahet sipas dy periudhave: te sizmicitetit historik dhe sizmicitetit instrumental. Sizmiciteti historik bazohet në informacionin e mbledhur nga burime të ndryshme dhe katë bëjë me atë periudhë të historisë kur tërmetet ende nuk regjistroheshin në rrugë instrumentale. Sizmiciteti instrumental identifikohet me shekullin e 20<sup>te</sup>.

## **Komuniteti lokal dhe social-ekonomia**

Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak. Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë është 682 banorë km<sup>2</sup>. Kjo bashki përbëhet nga 25 njësi administrative. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra. Tirana është bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje. Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë



Erzen, lumi i Tiranës dhe lumi Tërkuzë. Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësirë. Në territorin e bashkisë së re gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit. Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit. Komuna e Kasharit, e cila përfshihet në territorin e bashkisë së re konsiderohet zona më e industrializuar e vendit, si pasojë e përqendrimit të bizneseve dhe industrisë përgjatë autostradës Tiranë-Durrës. Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë te blegtoaria dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizmi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirin dhe drurët frutorë.

## **8. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE, NË MJEDIS, TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NE BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR**

### **Identifikimi dhe karakterizimi i ndikimeve sociale dhe mjedisore**

Në kete kapitull analizohen e karakterizohen ndikimet sipas fazave të zhvillimit të projektit, duke konsideruar si fazën e ndërtimit, ashtu edhe atë të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Në analizë merren në shqyrtim të gjithë elementet mjedisore dhe jepen efekte e pritshme negative per secilin element mjedisor. Aktiviteti ekonomik, popullsia dhe levizshmëria e mjeteve është e madhe duke e konsideruar si një ndikim të rëndësishëm. Por konsiderohet i një niveli te ulët duke marrë parasysh aktivitetet që do të kryhen gjate punimeve.Ndikimet mjedisore e sociale të projektit janë konsideruar në dy fazat e tij; atë të ndërtimit dhe të funksionimit. Nëse faza e ndërtimit ka një qartësi kohezgjatjeje, ajo e operimit dhe/apo e mbylljes janë krejtësisht të varura nga mirëmbajtja e objekteve.

### **Ndikimet social-ekonomike te projektit**

Për vete natyrën e territorit ku do të kryhen punimet per ndërtimin e objektit, duhet theksuar fakti që ky projekt nuk prek në mënyrë negative prona private apo aktivitete ekonomike, vlera sociale etj. Gjithashtu, nuk pritet te shkaktojë demtime të vlerave ekonomike apo aktiviteteve të biznesit dhe karakteristikave sociale. Duke qënë një objekt i cili eshte ne qender te qytetit afer qendres se banuar pritet të ketë ndikojë ne trafikun e zonës ose te krijojë pengesa në rrugët kryesore që mund te ndikojë në jetën e përditshme të banorëve të zones. Implementimi i projektit kërkon specialistë dhe punëtorë. Numri i punëtorëve që do të punojnë për ndërtimin do të jetë një burim punësimi për punëtorë të kualifikuar dhe jo të kualifikuar gjatë gjithë periudhes.

Kjo do te sjellë një impakt pozitiv tek popullsia vendase të cilët do të perfitojnë në dy mënyra nga ndërtimi:

- Krijimin e punesimit direkt
- Fitimi indirekte për bizneset vendase

### **Ndikimet ne mjediset specifike social kulturore**

Ndër ndikimet negative socio-kulturore ndonëse klasifikohen ne ato gjatë fazes së ndërtimit dhe ato gjate fazes se veprimit, janë konsideruar vetem të parat. Gjate fazës operuese nuk pritet të ketë ndikime mbi vlerat arkeologjike, historike apo kulturore etj. Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitekitektonike.

### **Ndikimet e përgjithshme ndërtimore dhe orientime per masat zbutëse**



Territori i punimeve gjate fazës së ndërtimit do të kufizohet në minimumin e mundshëm të sipërfaqeve të objektit që do të ndërtohet. Për të gjitha rastet do të merren masa të menjehershme sipas planit të menaxhimit të paraqitura në kapitullin e mëposhtëm.

### **Ndikimet në burimet ujore**

Ndërtimi i objektit ka si impakti potencial ndotjen e ujrave sipërfaqesore si rezultat i germimeve për themelet, mbetjet, baltat e gjeneruar nga përdorimi i makinerive të rënda ose shkarkimi aksidental i lubrifikateve, solventeve, bojrave dhe vajrave.

## **9. PËRSHKRIM PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMA, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;**

### **Ndikimet e mundshme gjatë fazës së ndërtimit**

Sistemi i ujrave sipërfaqesore pritet të pësojë ndikim gjatë fazës së ndërtimit si rezultat i punimeve me germime nga mbeturinat, balta e gjeneruar nga përdorimi i makinerive të rënda ose nga derdhja aksidentale e lubrifikantëve, vajrave, naftës etj. Përsa i përket ujrave nëntokesore dhe habitateve ujore të zonës janë të pasura por ndodhen larg zonës ku do të punohet dhe ndikimi konsiderohet i ulët. Ndotjet aksidentale të ujrave sipërfaqesore e nëntokësore, mund të ndiqen nga pasoja në shendet, shkatërrim të habitateve etj. Këto pasoja mund të vijnë si rezultat i gjermimeve për hapjen e themeleve. Për të parandaluar ndotjet aksidentale, apo evituar pasojat e tyre, vëmendje e veçantë do të kushtohet respektimit të rregullave teknike dhe aplikimit të eksperiencave me të mira inxhinierike në lidhje me rastet e aksidenteve.

### **Ndikimet e mundshme gjatë fazës së funksionimit të projektit**

Nuk pritet të ketë ndikime të konsiderueshme negative gjatë fazës së operimit. Në raste të demtimeve të elementeve funksionale të objektit, si impakti potencial është ndotja e ujrave sipërfaqesore nga mbetjet, balta e gjeneruar nga përdorimi i makinerive të rënda ose shkarkimi aksidental i lubrifikateve, solventeve, bojrave etj. Nëse një fenomen i tillë ndodh, do të ketë impakt të konsiderueshëm.

### **Ndikimet negative në tokë dhe mbetjet**

Edhe ndikimet negative në tokë janë parashikuar si për fazën e ndërtimit edhe për atë të funksionimit /mirëmbajtjes. Për të paracaktuar ndikimet në tokë duhet analizuar e gjitha zona në të cilën do të kyhet ndërtimi.

### **Ndikimet e mundshme gjatë fazës së punimeve**

Bazuar në këtë tip projekt mbetjet nga ndërtimi janë të konsiderueshme duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një ndërtim të ri. Pritet që ndikimi në tokë të jetë mesatar duke marrë parasysh punimet që do të kryhen. Duke u bazuar në studimet e tokës dhe karakteristikave të saj janë marrë parasysh në fazën e ndërtimit të objektit. Ndikime të tjera mund të jenë dhe sintetike, të vajrave lubrifikante dhe të materialeve të ndërtimit, të cilat do të gjenerohen nga punëtorët. Ndotja e tokës, gjatë ndërtimit mund të ndodhë nga depozitimi i mbetjeve aksidentale nga makineritë. Në varesi të tipit të ndotjes do të mund të përcaktohet nëse dëmi është afatshkrutë apo afatgjatë. Megjithatë madhësia e këtij impakti pritet që të jetë mesatare.



### **a) Mbetjet**

Gjate ndertimit parashikohen të kryhen punime ne tokë me anë të punimeve me gërmime ose nivelime të cilat do të shtrihen gjate gjithë zonës së projektit. Kryesisht do të jene mbetje të cilat do të vinë nga prishjet e jashtme dhe te brendshme te cituara dhe ne kapitullin e mesiperm. Nje pjese e konsiderueshme do te riciklohen për ndërtim. Pjesa tjetër do të grumbullohet dhe do të depozitohet ne vend depozitimin përkatës në bashkëpunim me autoritetin vendor bazuar edhe ne VKM Nr. 575, date 24.06.2015, ‘‘Per menaxhimin e mbetjeve inerte’’ pas miratimit te lejeve perkatese.

*Materialet e ketyre lloj mbetjeve janë:*

Beton

Dhera të germuara (gurë ose baltë)

Materiali druri

Materiale plastike

Një pjesë e rëndësishme është edhe transporti i mbetjeve ne vendepozitimet përkatëse. Sipas ligjit të ndërtimit me marrjen e lejes së ndërtimit lidhet një kontrate e licencuar për këtë lloj shërbimi me subjekt të licencuar. Pas transportit, këto mbetje do të trajtohen në vendepozitim përkatës në përputhje me kontratën me subjektin.

### **Ndikimet e mundshme gjatë fazes se shfrytezimit të projektit**

Ndikimet negative të mundshme gjatë fazës se shfrytezimit, mbeten ato të natyres aksidentale. Keto ndikime mund të rrezikojnë seriozisht ndotje dhe kontaminim te tokës të cilat mund të vijnë nga erozioni.Ky projekt ndodhet në një zonë fushore dhe rreziku i erozionit nuk parashikohet te jete prezent.

### **Ndikimet në ajër**

Ndikimet ne ajër, sikurse ato në ujëra dhe tokë, janë konsideruar për të dy fazat; atë të ndërtimit dhe operimit. Cilësia e ajrit gjatë fazës së ndërtimit të projektit do të ndikohet tërësisht nga ngagërmimet. Norma Shqiptare i referohet respektivisht normave të emisioneve të ajrit (VKM,numër 435i datës 12.09.2002) dhe normat për cilësinë e ajrit urban (VKM No. 803 i datës 04.12.2003).Puna ndërtimore mund të shkaktoj ndotje pjesërisht duke i tejkaluar kufinjte e lejuar për shkak të kamionëve dhe zhvendosjeve te dheut.

### **Ndikimet negative gjate fazes se ndertimit**

Volumi i konsiderueshëm i materialeve të ndërtimit do të transportohet në vendet e punimeve me kamion duke shkaktuar një sasi gazesh djegiese (CO, NOx, tymi, dhe HC), dhe automjetet ligjërisht duhet t’i respektojnë ato. Rritja e përkohshme e trafikut gjatë fazes së ndërtimit mund të krijojë pasojatë tjera të ndryshme si krijimi i pluhurit dhe emetimeve të shkarkimeve të gazeve mund të ndikojnë nëshëndetin e njerëzve me stafit të punëtorëve duke qenë se shkaktojnë probleme respiratore.

### **Ndikimet negative gjate fazes se operimit/mirembajtjes**

Gjate fazës së operimit ndikimet pritet te jene te pakonsiderueshme pasi shkarkimet nuk do të jenë të pranishme. Megjithate duhen te merren parasysh situatat aksidentale ne cilat mund të krijojnë ndikime të cilat parashikohen të jene në nivele të ulta.

### **Ndikimet ne zonat e gjelbërta specifike dhe biodiversiteti**



Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë

Cel. +355(0)694058048

e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,

Tel +355 4 2456016,

e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

Terreni se ku do te ndertohet objekti eshte territor pa bimesi . Gjithashtu perreth ndodhen vetem ndertesa te tipit banim qe variojne nga 2-5 kate dhe parcela te cilat nuk kanë siperfaqe me bimesi te lartë.

### **Ndikimet e mundshme gjatë fazës së ndërtimit**

Heqja e bimësisë në përgjithësi nuk do të çojë në shkatërrimin e habitateve me vlera të ndryshme si për florën dhe faunën (p.sh. gjitarët, zogjtë, zvarranikët, insektet) që jetojnë në zonën e parashikuar për tu kryer punime. Ajo nuk do të ndikojë gjithashtu në migrimin e kafshëve që jetojnë atje dhe krijimin e habitateve të reja për speciet me të tjera preferencë habitati. Si pasojë e këtyre nderhyrjeve që parashikohen nuk do të kemi degradim të mbulesa bimore duke pakesuar edhe komunitetin faunistik. Ky objekt nuk ndodhet ne zona të konsideruara Monumente Natyre apo Zona të Mbrojtura.

### **Ndikimet e mundshme gjatë operimit te projektit**

Projekti nuk do të prodhojë asnjë degradim të rëndësishëm apo shndërrim të zonave të rëndësishme pyjore dhe të habitateve pyjore të rëndësishme. Duke marrë parasysh ndikimet aksidentale që mund të ndodhin në ujë dhe në tokë mund të themi se vetëm në raste të tilla mund të kemi ndikim ne florën dhe faunën e zonës ku do të kryhen punime.

### **Ndikimet ne peisazh**

Për këtë projekt peisazhi nuk do të ketë ndikim te madh duke qëne se kemi te bejmë me nje objekt te ri. Duke u bazuar ne punimet e këtij projekti, impakti vizual do te ketë ndryshime te konsiderueshme krahasuar me situaten aktuale por do te ketë arkitekture te rregullt dhe ne harmoni me peisazhin dhe ndërtimet përreth. Depozitimi i mbetjeve te ngurta në ambientin përreth nuk do të lejohet gjatë fazës së ndertimit, duke shmangur keshtu grumbullimin dhe krijimin e pirqjeve te dheut.

### **Ndikimet ne zhurma**

Levizja e mjeteve të transportit të materialeve, mund të shkaktojë zhurmë gjatë fazës së ndërtimit. Gjithashtu përdorimi i makinerive gjatë punimeve, mund te jetë një burim zhurmash. Niveli i zhurmave në kete projekt mund të rritet përkohësisht. Zona e këtoj projekti është urbane dhe ndjeshmëra ndaj zhurmave është e konsiderueshme. Gjithashtu gjate fazes se operimit zhurmat e emetuara nga punimet e mirembajtjes ose shkarkimeve elektrike duhet te mbahen ne nivele te lejuara.

## **10. MUNDESINE E REHABILITIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR DHE MUNDESINE E KTHIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR TE SIPERFAQES NE GJENDJEN E MEPARSHME, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TE PERAFERTA ME REHABILITIMIN.**

### **KARAKTERIZIMI I NDIKIMEVE**

Më poshtë do të trajtohet karakterizimi i ndikimeve te identifikuar sipas fazave te projektit. Në analizën e ndikimeve janë konsideruar ndikimet pozitive e negative, ato direkte dhe indirekte, në nivele vendore, rajonale e kombëtare apo me gjerë. Ndikimet globale janë te pakonsiderueshme per kete nivel projekti, por sidoqofte janë marre në konsideratë.

#### ***Ndikimet pozitive***

Ndikimet pozitive gjate fazës se ndertimit kane origjine dhe natyre krejtesisht lokale. Ne menyre empirike mund te thuhet se shumë punonjes do te mobilizohen per ndertimin e objektit. Nje tjetër ndikim pozitiv mund te



konsiderohet gjenerimi i punes ne entitetet e tjera, aktiviteti i te cilave lidhet direkt me tregetine e materialeve te ndertimit, sherbimet, etj. Ky mund te konsiderohet si nje ndikim i rendesishem me natyre indirekte. Te tjera ndikime pozitive perftohen nga zbatimi i planit te menaxhimit per evitimin e ndikimeve negative dhe permiresimin / ruajtjen e kushteve te pershtatshme mjedisoro-higjenike. Efektet pozitive te kesaj faze jane shume me te gjera dhe me efektive nga ato te fazes se ndertimit. Per vete natyren e tij, projekti ndikon ne menyre te rendesishme aspektin ekonomik.

### ***Ndikimet Negative***

Duke patur parasysh natyren e projektit, karakterizimi i ndikimeve negative mbetet nje nga pjeset me te rendesishme te VNM-se ne fjale. Ndikimet negative potenciale/kumulative jane klasifikuar sipas fazave te zhvillimit te projektit dhe marrin ne konsiderate elementet e meposhtme:

### ***Burimin e ndikimit/rrezikut***

Burimet kryesore negative te ndotjes mbeten ato te nxitura nga proceset e ndertimit dhe aksidentet gjate fazave te operimit. Ndotjet nga gjenerimi i mbetjeve, operimi i mjeteve dhe automjeteve, gjeneratoret, etj, mbeten disa nga ndotesit kryesore. Zonat qe ndikohen nga ndikimet negative per vete natyren e projektit jane te ndryshme. Ndikimet do te shtrihen kryesisht vetem ne zonen ku do te behet ndertimi i objektit. Domethenien e ndikimit (efektet dhe kohezgjatjen) si dhe mundesite per tu zbutur.

### **Metodika e karakterizimit dhe analiza e ndikimeve**

Efektet e ndikimit merr ne konsiderate tre nivele; Te ulet, te Mesem dhe te Larte. Cdo element qe eshte pjese e efektit te ndikimit ka te njejtin rang. Shuma e niveleve, e pjestuar nga numri i elementeve te marre parasysh, jep mesataren e efektit te ndikimit. Shuma e efektit te ndikimit me kohezgjatjen e ndikimit jepet ne menyre empirike. Kolona e magnitudes se ndikimit, kategorizon ndikimet me 5 nivele, ku numri 1, eshte ndikimi me magnitudo me te ulet, dhe numri 5, si ndikimi me magnitudo me te larte. Magnituda e ndikimit eshte perlogaritur si nje raport mes efekteve te ndikimit dhe kohezgjatjes se tij, ndaj mundesive per zbutje apo efektivitet zbutjeje. Keshtu, qe ne shume raste ndikimet me sinjifikance te larte apo mesatare, per shkak te efektivitetit te masave zbutese kane nje magnitudo te mesme apo te ulet. Ne disa raste te tjera, me gjithë mundesine e masave zbutese, ndikimet mbeten te nje magnitudo te larte per shkak te moszbatimit te planit te menaxhimit per arsye te kostos se larte.

*Tabela e pergjithshme e ndikimeve eshte trajtuar me gjere ne ANEKSIN 1 te ketij studimi.*

## **11. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS**

### **Dëmtim i peisazhit**

Gjatë zbatimit duhet të tregohet kujdesi i duhur për të ruajtur peisazhin natyror në mënyrë që të parandalohet çfarëdo shkatërrim i panevojshëm, ndryshime në reliev etj.

### ***Eshte i domosdoshëm:***

Pastrimi i territoreve nga mbetjet gjatë ndertimit.  
Mbrojtja e mbulesës bimore,  
Ruajtja e karakteristikave te dherave dhe relievit etj.  
Nga zbatimi i këtij projekti, nuk parashikohen te priten pemë.





Me përfundimin e punimeve, të gjitha pajisjet dhe materialet e tepërta do të hiqen, dhe do te depozitohen ne terriore të caktuara per këtë qellim nga autoritetet vendore. Çdo mbjellje ne terrior, do te kryhet me bimë autoktone, me përjashtim te atyre me efekte aromatike, dhe dekorative.

Duhet të zvogelohen impaktet negative që vijnë si rezultat i ndertimit në nivelin me të ulët të mundshëm dhe që sigurojnë makineritë që operojne brenda zonës së ndërtimit.

Zonat e depozitimit do të pozicionohen ne menyre që te menjanohen impaktet e metejshme ne pronat private e banesat ekzistuese, pemet, gardhimet, etj. dhe si te tilla do të kenë prioritet për tu ndertuar apo do të lihen ne fund të kontrates së ndërtimit.

Materialet e gërmuara që janë te menduara per rishfrytezim do te menaxhohen dhe transferohen deri ne minimum dhe do te depozitohen në zona të caktuara nga pushteti lokal.

### **Reduktimi në biodiversitetit**

Ashtu sic u theksua tek permbledhja e ndikimeve, zona ne te cilen do të kryhet ndërtimi sdo të ketë impakt ne faunën e zonës. Gjithsesi, për të minimizuar dëmet ndaj kafshëve,eshte i nevojshem me nje bashkerendim veprimesh:

Të minimizohet dëmtimi dhe reduktimi i habitateve nga aktivitetet ndërtimore;

Minimizohet shkatërrimi i foleve dhe strofkullave;

Parandalojë, gjuetinë dhe mbledhjen e vezëve nga punëtorët e ndërtimit;

Ndalojë mbledhjen e druve të zjarrit nga zonat e punës;

Minimizojë dëmet ndaj rrjedhave ujore nga punimet tokësore dhe nga hedhja e mbeturinave të papershtatshme;

Këto do të arrihen nëpërmjet:

Përdorimi i vendeve te përcaktuara dhe të miratuara per hedhjen mbeturinave të lëngshme dhe solide

Edukimi i ekipeve ndërtimore mbi ndikimin e shqetësimit dhe dëmtimit të habitateve dhe masave parandaluese te tyre;

Ndalimi i rreptesishem i ndezjes se zjarrit;

Te sigurohen qe kushtet e punësimit te parashikojne dënime të rënda për prishje të panevojshme të habitateve të rëndësishme;

Para çdo aktivitet ndërtimi duhet të kryhet sigurimi me gardh i zonave te ndjeshme.

### **Toka dhe ndotja e ujit**

Gjatë punimeve duhet të kryhen të gjitha aktivitetet në një mënyrë që të parandaloje ndotjen e tokës nga derdhjet aksidentale të lëndës së ngurtë dhe lënget, ndotesve, mbeturinat, dhe ndotësve të tjerë të papershtatshem.

Nëse një derdhje serioze ndodh:

Duhet të hiqen apo pastrohet tërë toka e kontaminuar

Dherat e larguara duhet te zevendesohen nga material te ngjashme.

Aktivitetet do të kryhet në një mënyrë që do të parandalojë hyrjen ose derdhjen aksidentale të lëndës së ngurtë, ndotesve, mbeturinat, dhe ndotësve të tjerë të pakëndshëm.

### **Erozioni, trazimi dhe ngarkesa e sedimenteve**

Gjatë ndërtimit duhet te kryhet një procedurë spastrimi te vendit që ndan shtresen e punueshme dhe ruan atë nën kushte të përshtatshme për ripërdorim

Për këtë arsye duhet që:

Që ndërmerren të gjitha masat duke përfshirë te gjitha teknikat mbrojtese për të ruajtur zonat e spastruara nga precipitimi i materialit te ndotur.



Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë

Cel. +355(0)694058048

e-mail: [studio@tower.al](mailto:studio@tower.al), [studiotower07@gmail.com](mailto:studiotower07@gmail.com)

Adresa: Rr."Gjik Kuqali", Pll.23/2 Shk.1,Ap.1 Kati 1, Tirana,

Tel +355 4 2456016,

e-mail : [shpk.taulant2@gmail.com](mailto:shpk.taulant2@gmail.com)

Puna gerryese duhet të kryhet në një mënyrë që do të parandaloje ujin e ndotur te derdhet ne themele, kanale etj dhe prej atje te derdhet ne lumë.

Sasite e tepërta të materialeve të padëshiruara dhe agregate te magazinuara ne vend duhet të shmangen.

Kur magazinimi është i nevojshem, duhet të sigurohet qe pirgjet dhe rezervat janë të vendosura në vende ku nuk lejojnë derdhje drejtpërdrejtë dhe janë në pjerrësi të tokës në më pak se 1.5%.

Të gjitha grumbujt dhe pirgjet do të jenë të një madhësie dhe stabiliteti që do të sigurojnë evitimin e rrezikut te lëvizjes masive gjatë periudhave të reshjeve me intensitet të lartë territorin e objektit.

## **Zhurma dhe pluhuri**

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit kryesisht do të rrjedhin nga operimi i objektit dhe pajisjeve.

*Per kete arsye:*

Duhet të sigurohet qe të gjitha pajisjet e tij te jene të përshtatshme per mbytyjen e zhurmës që do të reduktojnë emetimet e zhurmes

Te gjitha paisjet e tjera do te pajisen me aparate te pershtatshem kunder zhurmes ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit.

Automjetet që janë tepër të zhurmshme për shkak të punes difektoze të motorrit nuk do teperdoren per ndertim.

Duhet të shmangët shkaktimi i zhurmave, dridhjeve apo pluhurave ne territoret e punes.Ne rast se ndikime te tille, do te jene ne nivelin e mbi normave te legjislacionit ekjzistues,duhet të pezullohen punimet deri ne permiresimin e situates dhe evitimin e ndotjeve te ajrit te lartpermendura.

Aktiviteti me i zhurmshem aktual, nuk pritet te jete i nevojshem per kete projekt.

*Masat specifike per evitimin e pluhurit do të përfshijnë:*

Lagien e kantierit dhe rrugëve hyrëse;

Përdorimin e rrethimeve mbrojtese/izoluese te pershtatshme;

Mbulimi i të gjitha automjeteteve që transportojnë materiale qe nxjerrin pluhur te tepruar;

Mos lejimin kamionëve të mbingarkuar.

Asnje impiant i përdour në vend nuk do të lejohet të shkaktojë një bezdi publike si pasojë e zhurmës.

*Ne këtë mënyrë duhet:*

Zbatueshmëri duke përfshirë mirëmbajtjen e duhur të projektit dhe angazhimin për të ulur zhurmën e krijuar nga veprimet në vend.

Të gjitha makinat dhe impiantet mekanike do të përshtaten me silenciator efektive dhe të mbajtur në funksion të mire gjatë kohës së kontratës.

Kompresoret do të jenë modele lehtësuese të pershtatura me kapake akustike të duhur me viza dhe të mbyllur të cilët do të mbahen të mbyllur kurdo që makina punon dhe të gjitha mjetet vartëse pneumatike do të përshtaten me silenciatorë.

Makineria që është përdorur pa ndërprerje do të fiket ose t'i ulet shpejtesia ne minimum (ose t'i mbyllet valvula) gjate periudhes kur nuk perdoret.

Cdo impiant si psh gjenerator ose pompe, që kërkohet të veprojë para dhe pas orëve të ligjshme të punës, do të rrethohet nga një mbyllje akustike ose nga ndonje mbyllës portativ.

*Masat specifike per evitimin e zjarrit dhe reagimin ndaj tij apo aksidenteve do të përfshijnë:*

Rrespektimin e rregullores kunder zjarrit dhe vendosjen e pajisjeve për mbrojtjen ndaj zjarrit në kampet e punës Organizimin e territoreve të punes në menyre të atillë që të parandalojnë zjarret apo aksidentete tjera.



Mbajtjen në gadishmeri të mjeteve me ujë dhe pompave përkatëse të emergjences, grumuj terëres per kontrollin e zjarrit etj.

Ngritjen e nje sistemi te reagimit emergjent, me nje rrjet te mirecaktuar veprimesh dhe komunikimesh.

Ekspozimin ne vende të dukshme te numrave te zjarrfikses, policise, ambulances etj.

Perfshirjen ne sistemin e planit të menaxhimit të trafikut, edhe të akseseve të ermergjencës në raste zjarresh e aksidentesh.

Pajisjen e territorve te punes dhe objektit me kutitë e nderhyrjes se shpejtë, me shenjat përkatëse dhe lehtesisht të dukshme.

## **Shkatërrimi i mbetjeve**

Shkatërrimi i të gjitha materialeve të ndërtimit të tepërta dhe mbeturinave do të kryhet në përputhje me rregullat e Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta.

*Per ketë arsye:*

Mënyra normale e shkatërrimit do të përfshijë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndotjen e ujit dhe te ajrit, bllokime te kullimit, rreziku nga zjarri dhe dëmtimet e ekosistemeve. Vetem zona hedhesh te miratuara / groposje do të përdoren për hedhjen e mbeturinave të tepërta.

Dherat e tepert do të hidhen menjëherë në mënyrë që të minimizojnë kohën e magazinimit në vendin e ndërtimit dhe rrezikun e erozionit dhe shkarkimin e sedimenteve.

Këto materiale do të kërkohen më vonë në Programin e punës që ata do të ruhen në mënyrë të duhur.

Materialet e dheut nuk do të hidhen në gropa nëse ripërdoren si mbulesë e përditshme apo përfundimtare.

Materialet e gërmuara që jane të menduara për rishfrytezim do te menaxhohen dhe transferohen derine minimum.

Me përfundimin e objektit të ndërmerret masa me ndihmën e inspektimeve. Kjo mund të ulë impaktin e mundshem ne të ardhmen për humbjen e dherave apo impaktet që lidhen me terrenin.

## **Siguria publike dhe siguria e punëtorëve**

Territori dhe zonat per riparim do të jenë te mire reklamuar me shenjat perkatese per ruajtjen nga aksesit i paautorizuar dhe shenjat paralajmëruese të përshtatshme te ngritura.

Të gjitha zonat e Projektit do të percaktohen si zona per “kokore”.

Pervece zbatimit te Rregullores dhe Sigurise Teknike”, te gjithë punonjesit duhet te pajisen me uniformat e punes, te njihen me planin e reagimit ne rast aksidentesh, etj.

Procesi i monitorimit perfshihet ne nje program te ngritur mbi planin e monitorimit gjate ndertimit dhe ate gjate operimit.

## **Monitorimi gjate ndertimit**

Monitorimi nga menaxheri i ndërtimit do të jetë kryesisht në vendet e ndërtimit dhe të kampit nga kontraktori dhe Inspektoriati Mjedisor. Monitorimi i vendeve të tjera do të ndërmerren nga Kontraktori me vizita të kohëpaskohshme nga specialistet e dhe Bashkisë Tirane dhe njesite administrative. Për një projekt si ky, këto çështje do të trajtohen si nga ana cilësore edhe ajo sasiore, përveç zhurmës nga pajisjete ndërtimit dhe emisionet nga gjeneratorët, për të cilën Kontraktori do të sigurojë pajisjet e duhura të monitorimit.

Për matjet e zhurmës, si pike referimi do te merren matjet ekzistuese, qe do te konsiderohen si pika referimi te gjendjes mjedisore. Lexime fillestare do të merren në vende të ndryshme brenda zonës së projektit dhe procesi fillon para fillimit të ndërtimit në mënyrë efektive dhe do të përbëjë monitorimin bazë.



## 12. ANALIZA E NDIKIMEVE (INFORMACION PËR KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA)

Ndikimet negative ne mjediset natyrore							
Ndikimet negative ne toke dhe relief							
Nr	Burimet e rrezikut/ndikimit	Zona qe do te preket	Domethenia e ndikimit/Rrezikut		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efekti i ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Ndryshime ne topografine e zones e shkaktuar nga germimet dhe hedhjet/depozitimet	Territori dhe mjediset perreth	Efekte te mesme per shkak te ndryshimeve mjaft te vogla	Afat shkurter	Po		3
2.0	Ngjeshje dherash dhe ndotje gjate ndertimit	Territori i zones ne ndertim	Efekte te vogla	Afat shkurter	Po		3
3.0	Kontaminime te dherave nga mbetjet gjate punimeve, nevojat biologjike te punonjesve, mbetjet e tjera ushqimore dhe paketimet, plastikat etj	Kampet e punes, parkingjet dhe territoret e punes etj	Efekte te larta	Afat Mesem	Plotesisht		2
4.0	Erozion toke dhe rrezik rreshkitjeje	Territori i zones ne ndertim	Efekte te mesme	Afat shkurter	Plotesisht		1
5.0	Humbje e mbuleses se gjelber dhe shkaterrim i formacioneve te dherave	Territori i zones ne ndertim	Efekte te mesme	Afat mesem	Pjeserisht		1
6.0	Ndotje ne zonat ku do te depozitohet apo hidhen mbetjet nga punimet e germimet	Zona te rastesishme ku mund te ndodhin depozitime ilegale	Efekte te larta	Nuk mund te percaktohet (varet nga receptori)	Plotesisht		3
7.0	Rrezik - Kontaminim i tokave nga ndotjet aksidentale	Territoret e punimeve, rruget e transportit etj.	Efekte te mesme	Nuk mund te percaktohet	Pjeserisht		2
8.0	Mbishfrytezim i territoreve nga do te merret lenda e pare (p.sh rerat, zhavorri etj)	Zonat per shfrytezim,brijet detare, lumore apo guroret	E pa percaktuar	Afat mesem	Plotesisht		2



Ndikimet ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore							
Nr	Burimet e ndikimit/rrezikut	Zona qe do te preket	Domethenia e ndikimit/rrezikut		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Ndotja e ujrave siperfaqesore e nentokesore nga materialet e ndotura te germuara	Te gjitha territoret ku do te punohet	Te larta	E Mesme	Po		2
2.0	Ndotja nga perhapja aksidentale e lendes se kontaminuar organike/ujrave te zeza	Territori ku do te punohet	Te larta	Afat mesem	Pjeserisht		2
3.0	Ndotje e ujrave siperfaqesore nentokesore nga mbetjet organike, bojrat kimike, etj	Kampet e punes	Te larta	Afat mesem	Pjeserisht		2
4.0	Ndryshime per kapacitetin uje-kembyes nga ngjeshja e tokes	Ne territoret ku do te punohet	Te ulta	Afat Shkurter		Po	1
5.0	Ndryshime ne rrjedhjet siperfaqesore per shkak te punimeve te ndertimit dhe operimit	Territori i projektit	Te ulta	Afat mesme		Po	3
6.0	Ndotje apo kontaminim i ujrave siperfaqesore dhe nentokesore nga rrjedhjet natyrore te ujrave te ndotura prej depozitimeve te papershtatshme te lendeve te ndotura te germuara, mbetjeve nga punimet, nga permbytjet e zonave te depozitimeve, etj	Territoret e punes	Te Mesme	Afat mesme	Pjeserisht		2
7.0	Ndotje aksidentale nga rrjedhjet e hidrokarbureve	Ne rruget e transportit, kampet e punes apo parkinget	Te Mesme	E papercaktuar	Pjeserisht		3
Ndikimet ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore							
Nr	Burimet e ndikimit/rrezikut	Zona qe do te preket	Domethenia e ndikimit/rrezikut		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Ndotje nga aromat, infeksione/rreziqe ne shendet nga materialet e germuara, carjet aksidentale te tubacioneve etj	Territoret ku do te punohet	I Mesem	Afat shkurter	Po		2
2.0	Zhurma nga ngjeshjet e dherave, kompresoret e gjeneratoret, trafiku etj	Territoret ku do te punohet	I Mesem	Afat Mesem	Pjeserisht		3



3.0	Ndotje e ajrit nga shkarkimet e makinerive me motor, gjeneratorët etj	Territoret ku do të punohet	I Mesem	Afat mesem	Pjeserisht		3
<b>Ndikimet negative ne habitatet dhe biodiversitet</b>							
Nr	Burimet e ndikimeve/rreziqeve	Zonat që mund të preken	Domethenia e rrezikut/ndikimit		Mund të zbutet	Nuk mund të zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Largim/dentim i specieve me status të vecante (gjueti e paligjshme, vrasje aksidentale)	Zona në ndërtim dhe përreth	Efekte të mesme	Afat mesem	Po		1
2.0	Dentim/shkatërrim dhefragmentizim habitatesh	Zona ndërtim dhe përreth	Efekte të mesme	Afat mesme	Po		1
3.0	Ndryshim i rrjedhave ujore dhe dentim i habitateve	Zona në ndërtim dhe përreth	Efekte të mesme	Afat mesme	Po		1
<b>Shendet, ruajtje dhe sigurim</b>							
Nr	Burimet e ndikimeve/rrezikut	Zonat që preken	Domethenia e ndikimit/rrezikut		Mund të zbutet	Nuk mund të zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Dentimi i kushteve normale të higjenes nga ndotja e ajrit, tokës dhe ujit	Punëtorët dhe personat që jetojnë apo ushtrojnë aktivitet në/përreth territoreve të punës	Efekte të larta	Afat shkurtër	Pjeserisht		3
2.0	Rrezikimi i jetës apo sigurisë nga aksidentet	Punëtorët dhe personat që jetojnë apo ushtrojnë aktivitet në/përreth territoreve të punës	Rrezik me efekt të lartë	Afat shkurtër/mesem	Po		3
3.0	Pengimi i aksesibilitetit me shërbimet e emergjencës në rast semundjesh të papritura, plagosjesh, zjarri, etj.	Zonat përreth që do të jetë në rikonstruksion	Rrezik I lartë	Afat mesem	po		3
<b>Ndikime ne vlerat arkeologjike, historike, kulturore apo fetare</b>							
Nr.	Burimet e ndikimeve/rrezikut	Zonat që preken	Domethenia e ndikimit/rrezikut		Mund të zbutet	Nuk mund të zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Rrezik - Dentime aksidentale të vlerave arkeologjike, historike, kulturore apo fetare	Te pa identifikuar	Te panjohura	E panjohur	Po		2



Tabela 5.2 Ndikimet negative gjate fazes se operimit/mirembajtjes

Ndikimet negative ne mjediset natyrore							
Ndikimet negative ne toke dhe relief							
Nr	Burimet e rrezikut/ndikimit	Zona qe do te preket	Domethenia e ndikimit/Rrezikut		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Kontaminime aksidentale te dherave dhe tokes nga demtimet e rrjetit apo keq funksionimi i projektit etj	Zona ne ndertim dhe perreth	Efekte te larta	Afat Mesem	Po		1
2.0	Ndotje ne zonat ku do te depozitohet apo hidhen mbetjet nga punimet e mirembajtjes apo shllamet	Zona te rastesishme ku mund te ndodhin depozitime ilegale	Efekte te larta	Nuk mund te percaktohet (varet nga receptori)	Po		1
Ndikimet ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore							
Nr	Burimet e ndikimit/rrezikut	Zona qe do te preket	Domethenia e ndikimit/rrezikut		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Ndotja e ujrave siperfaqesore e nentokesore nga materialet e ndotura te germuara apo debris gjate mirembajtjes	Te gjitha territoret ku do te mirembahet	Te larta	Afat shkurter	Po		1
2.0	Ndotje e ujrave siperfaqesore e nentokesore nga mbetjet organike, bojrat kimike, gjate mirembajtjes	Te gjitha territoret ku do te mirembahet	Te mesme	Afat shkurter	Po		1
3.0	Ndotje apo kontaminim i ujrave siperfaqesore dhe nentokesore nga rrjedhjet natyrore	Territoret ku do te punohet	Te Mesme	Afat shkurter	Pjeserisht		2
4.0	Ndotje aksidentale nga rrjedhjet e hidrokarbureve	Ne rruget e transportit	Te Ulta	E shkurter	Pjeserisht		1
Ndikimet negative ne ajer							
Nr	Burimet e ndikimeve/rreziqeve	Zonat qe mund te preken	Domethenia e Rrezikut/Ndikimit		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			



1.0	Ndotje nga aromat, infeksione/rreziqe ne shendet nga materialet e germuara,carjet aksidentale te tubacioneve etj	Territoret ku do te punohet	I mesem	Afat shkurter	Po		1
<b>Shendet, ruajtje dhe sigurim</b>							
Nr	Burimet e ndikimeve/rrezikut	Zonat qe preken	Domethenia e ndikimit/rrezikut		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Demtimi i kushteve normale te higjenes nga ndotja e ajrit, tokes dhe ujit gjate punimeve te mirembajtjes	Punetoret dhe personat qe jetojne apo ushtrojne aktivitet ne/perreth territoreve te punes	Efekte te larta	Afat shkurter	Po		1
2.0	Rrezikimi i jetes apo sigurise nga aksidentet	Punetoret dhe personat qe jetojne apo ushtrojne aktivitet ne/perreth territoreve qe mirembahen	Rrezik me efekt te larte	Afat shkurter /mesem	Po		1
<b>Konflikte sociale-ekonomike</b>							
Nr.	Burimet e ndikimeve/ rrezikut	Zonat qe preken	Domethenia e ndikimit/rrezikut		Mund te zbutet	Nuk mund te zbutet	Magnituda e ndikimit
			Efektet e ndikimit	Kohezgjatja e ndikimit			
1.0	Pengime te shperndarjes se mallrave, aktiviteteve dhe furnizimeve ne markete dhe sherbime te tjera	Zonat perreth qe do te mirembahet	Efekte ulta	Afat shkurtra	Po		1





## ANEKSI 2: PLANI MONITORUES MJEDISOR

Faza	Cfare (eshte parametri qe do te monitorohet?)	Ku (eshte parametri qe do te monitorohet?)	Si(do te monitorohet parametri?)	Kur(Percakto frekuencen apo vazhdueshmerine?)	Pse (Duhet te monitorohet parametri?)	Kostoja (Ne rast se nuk eshte perfshire ne buxhet)	Kush (eshte pergjegjes per monitorimin?)
<b>Gjate Ndertimit/ rehabilitimit</b>	Njoftimi dhe informimi i punonjesve dhe komunitetit per rëndesine e mbrojtjes se mjedisit dhe shendetit	Ne zonat ku ndertohet	Mbajtja e nje logoje te njoftimit te punetoreve dhe komunitetit, perpjekjet per informim lejet e marra, raportet mbikqyresit per pershtatshmerine e zbatimit me planin e menaxhimit, ruajtjen e punetoreve dhe ankimimet e mundshme Shenjat dhe tabelat apo dokumentimet e njoftimeve e informimeve duhet e inspektohen edhe nga ana vizuale.	Vazhdimisht gjate punimeve te ndertimit	Per tu siguruar se veprimet kryhen ne perputhje me kerkesat e ruajtjes se shendetit dhe mbrojtjes se mjedisit.	Perfshihet ne koston e mbikqyrjes	<b>Kontraktori per zbatimin dhe mbikqyresi per identifikimin dhe raportimin</b>
<b>Gjate Ndertimit/ rehabilitimit</b>	Monitorimi i ndotjeve nga rrjedhjet, shkarkimet etj, Analizat fiziko kimike dhe sasiore(volumet)	Ne zonat e ku do te nderhyet	Sipas kerkesave te Institutit te Shendetit Publik dhe Drejtorise se Higjenes	Sipas nderhyrjeve	Per tu siguruar referencen e cilesise se mjedisit gjate nderhyrjes dhe pas tij	Perfshire ne koston operacionale	<b>Institutet e percaktuara nga legjislacioni Shqiptar</b>



<b>Gjate Ndertimit/ rehabilitimit</b>	Cilesia e tokave dhe ajrit	Ne zonat ku ndertohe apo nderhyet dhe territoret perreth	Inspektim visual, aromatik dhe degjimore i gjenerimit te pluhurave, te zhurmave, aromave te padeshirueshme, rrjedhjeve te palejushme, mbetjeve te ngurta ne vende te papershtatshme, sigurimi qe grumbulluesi dhe larguesi i mbetjeve eshte nje kompani e licensuar, identifikimi i djegjeve ilegale etj.	Vazhdimisht gjate ndertimit dhe rregullimeve	Per tu siguruar se veprimet kryhen ne perputhje me kerkesat e ruajtjes se shendetit dhe mbrojtjes se mjedisit.	Perfshire ne koston e monitorimit (buxhet) dhe kosto e mbikqyrjes	<b>Zbatimin kontraktori, ndersa mbikqyrjen dhe raportimin nga mbikeqyresi.</b>
<b>Gjate ndertimit/ rehabilitimit</b>	Niveli i zhurmave	Ne territoret e punes dhe perreth tyre	Nepermjet shqisave, mbledhjes se ankesave dhe nese duhet nepermjet matjeve	Vazhdimisht gjate punimeve	Sigurimi nese zhurmat jane nen nivelet e lejuara	Kosto e Kontrak. dhe raportimi i mbikqyresit	<b>Kontraktori per matje dhe mbikqyresi per raportim</b>
<b>Gjate ndertimit/ rehabilitimit</b>	Cilesia e ujrave	Ne territoret e punes dhe perreth tyre, si dhe ne mjediset pritesese	Inspektime vizuale dhe pas konstatimit, nese duhet matje dhe analiza kimike	Vazhdimisht gjate punimeve	Per tu siguruar per cilesine e ujrave dhe nevojen per menaxhim te tyre	Kosto e kontraktorit dhe e mbikqyresit	<b>Kontraktori per matje dhe mbikqyresi per raportim</b>
<b>Gjate ndertimit/ rehabilitimit</b>	Menaxhim mbetjesh	Ne territoret e punes dhe perreth tyre, si dhe ne mjediset pritesese	Inspektime vizuale per ndarjen e mbetjeve, mbikqyrja e marrjes prej kompanive te grumbullimit.	Vazhdimisht gjate punimeve	Per tu siguruar se nuk ka rrezik nga ndotjet dhe infeksionet gjate punimeve	Duhen perfshire ne koston e kontraktorit dhe mbikqyresit	<b>Kontraktori per zbatim dhe mbikqyresi per konstatim e raportim</b>
<b>Gjate ndertimit/ rehabilitimit</b>	Demtimi i vegetacionit dhe habitateve specifike	Ne territoret e punes	Inspektime vizuale	Vazhdimisht gjate punimeve	Per tu siguruar se nuk eshte demtuar	Kosto e mbikqyresit	<b>Kontraktori per zbatim</b>



<b>Faza</b>	Cfare (parametri qe do te monitorohet)	Ku(eshte parametri qe do te monitorohet)	Si (do te monitorohet parametri)	Kur(Percakto frekuencen apo vazhdueshmerine)	Pse(Duhet te monitorohet parametri)	Kostoja(Ne rast se nuk eshte perfshire ne buxhet)	<b>Kush(eshte pergjegjes per monitorimin)</b>
<b>Gjate operimit /mirembajtjes</b>	Cilesia e ujrave ne zonen e projektit	Ne gjithe zonen e projektit	Analizat e metalve te renda dhe ato orgaznike	Vazhdimisht	Per te vleresuar eficencen e objektit	Kosto operacionale	<b>Operatori</b>
<b>Gjate operimit /mirembajtjes</b>	Respektimi i masave mbrojtese	Ne territoret ku do te kete mirembajtje	Ne menyre vizuale	Vazhdimisht	Kontroll i rrezikut ne shendet	E perfshire ne buxhet	<b>Operatori</b>
<b>Gjate operimit/ mirembajtjes</b>	Respektimi i masave mbrojtese	Ne territoret ku do te kete mirembajtje	Ne menyre vizuale	Vazhdimisht	Kontroll i rrezikut ne shendet	E perfshire ne buxhet	<b>Operatori</b>
<b>Gjate operimit/ mirembajtjes</b>	<b>Rrjedhje,zhurma etj</b>	<b>Rrjedhjet e rrejtit te kanalizimeve</b>	<b>Ne menyre vizuale</b>	<b>Vazhdimisht</b>	<b>Kontroll i rrezikut ne shendet</b>	<b>E perfshire ne buxhet</b>	<b>Operatori</b>